

VENDIM
Nr. 135, datë 21.5.2026

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 207, DATË 9.9.2025 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘AMEL ENERGY’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET PRODHUES 2 mw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 415/4 prot., datë 19.5.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 9.9.2025, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Amel Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet prodhues 2 mw””,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Amel Energy” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin e nr. 207, datë 9.9.2025, vendosi të licencojë shoqërinë “Amel Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

- Në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi përcaktohet se shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.12.2025 dhe të depozitojë në ERE testimin e veprës, jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt. Ndërsa në pikën 4 përcaktohet se ky vendim është objekt rishikimi në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve në pikat 2 dhe 3.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Në kuadër të rakordimit të plotësimit të kushteve respektive të vendimit, ERE i ka rikujtuar shoqërisë detyrimin për depozitimin e sa përcaktuar në këto kushte, me shkresën me nr. 415 prot., datë 29.1.2026.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 415/1 prot., datë 6.2.2026, shoqëria ka bërë me dije se ka filluar ushtrimin e veprimtarisë brenda datës 31.12.2025, si dhe ka depozituar bashkëlidhur njoftimin përkatës drejtuar AKBN-së, për përfundimin e testimit 72-orësh; njoftimin drejtuar MIE-s dhe AKBN-së, në lidhje me përfundimin e punimeve dhe testimin e veprës, si dhe kontratat e furnizimit dhe shitblerjes së energjisë elektrike të nënshkruar me FTL sh.a., në datën 6.1.2026.

- Me shkresën me nr. 415/2 prot., datë 20.4.2026, ERE i ka kërkuar shoqërisë të depozitojë informacionin/dokumentacionin përkatës të testimit të veprës.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 415/3 prot., datë 27.4.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e testimit të veprës.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Rezulton se shoqëria ka filluar operimin brenda datës 31.12.2025 dhe ka dokumentuar në ERE testimin e veprës. Si e tillë, vlerësohet se ajo ka përmbushur kushtet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të vendimit nr. 207/2025, ndaj vlerësohet që këto pika të shfuqizohen.

- Në vijim të shfuqizimit të pikave 2 dhe 3, të vendimit nr. 207/2025, të ndryshuar, vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 4, si vijon: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet nga organi kompetent.

- Në kushtet kur pikat 2 dhe 3, të vendimit nr. 207/2025, të ndryshuar, janë përmbushur, vlerësohet se duhet të shfuqizohen.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 9.9.2025, si vijon:

a) Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 207, datë 9.9.2025, shfuqizohet;

b) Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 207, datë 9.9.2025, shfuqizohet;

c) Pika 4, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 207, datë 9.9.2025 ndryshon dhe bëhet: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Amel Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” (ALPEX) sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti